Kronikë

Tepelenë/ Qëlloi me kallash në ajër pas një konflikti me një person, pranga 42-vjeçari! Armën e kishte fshehur në zonë të pyllëzuar

Ngjarja fatmirësisht pa pasoja u regjistrua më 2 nëntor pas një konflikti mes të dyve në fshatin Peshtan.

Arma e zjarrit e sekuestruar

Redaksia
9 Nëntor, 13:32 | **Përditesimi: 9 Nëntor, 13:40**

Share

Tepelenë - Një 42-vjeçar ka rënë në prangat e policisë së Tepelenës pasi qëlloi në ajër me kallashnikov si shenjë kërcënimi për një 48-vjeçar.

Ngjarja fatmirësisht pa pasoja u regjistrua më 2 nëntor pas një konflikti mes të dyve në fshatin Peshtan.

Arma e zjarrit u gjet në një zonë të pyllëzuar të këtij fshati.

LEXO EDHE:
Zgjedhjet e pjesshme në 5 bashki/ Mentor Kikia: Berisha u fsheh pas kandidatëve të pavarur, pjesëmarrja s'pritej kaq e ulët, në Vlorë u bojkotuan

Ndërkohë gjatë kontrollit në banesën e 48 vjeçarit blutë gjetën dhe sekuestruan 1 armë gjahu dhe 1 gjerdan me fishekë gjuetie, të cilat i posedonte pa leje.

Njoftimi i policisë:

Si rezultat i intensifikimit të kërkimeve, shërbimet e Komisariatit të Policisë Tepelenë, në bashkëpunim me Stacionin e Policisë Këlcyrë dhe me shërbimet e DVP Gjirokastër, bazuar edhe në informacionet e siguruara në rrugë operative për vendndodhjen e një shtetasi në kërkim, në fshatin Peshtan, Këlcyrë, organizuan punën për kapjen e tij.

Në kuadër të operacionit policor të koduar "Koordinimi", u bë e mundur lokalizimi, kapja dhe arrestimi i shtetasit E. T., 42 vjeç, banues në fshatin Peshtan.

Ky shtetas ishte shpallur në kërkim pasi më datën 02.11.2025, pas një konflikti për motive të dobëta, ka qëlluar me armë zjarri në ajër për të kanosur shtetasin V. M., 48 vjeç, banues në fshatin Peshtan.

Gjatë operacionit, shërbimet e Policisë, gjatë kontrollit në një zonë të pyllëzuar të fshatit Peshtan, gjetën dhe sekuestruan armën e zjarrit me të cilën dyshohet se ky shtetas ka kanosur 48-vjeçarin, si dhe një sasi municioni luftarak, të cilat 42-vjeçari i kishte fshehur menjëherë pas ngjarjes.

Në vijim të operacionit, gjatë kontrollit të banesës së shtetasit V. M., shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan 1 armë gjahu dhe 1 gjerdan me fishekë gjuetie, të cilat i posedonte pa leje.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, për veprime të mëtejshme.

Xh.K/Shqiptarja.com

TAG: kallashnikov tepelenë Gjirokastër

Komento

Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Zgjedhjet e pjesshme vendore, si ju duket procesi i votimit?
9 Nëntor, 10:38

I rregullt | Me probleme | Nuk kam mendim

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

HOROSKOPI

Lajme të tjera

TEPELENË/ Procesi i votimit pa probleme, kandidati i pavarur, Guma shfaqet me bebin në krah
9 Nëntor, 14:20

Ardi Stefa: Votova për 'bukën e gojës'
Ardi Stefa
9 Nëntor, 13:30

Për herë të parë testohet numërimi i votave me IA në Tepelenë, ja si do funksionojë
9 Nëntor, 13:03

Komisionerja në Tepelenë komplimenton kandidatin me beben në krahë: Kryetar më të bukur nuk kemi parë ndonjëherë (VIDEO)
9 Nëntor, 13:02

Zgjedhjet e pjesshme në 5 bashki/ Dashnor Sula për Report Tv: Nuk do sjellin asnjë risi, PD të ishte me logon e saj në garë! PS e avantazhuar
9 Nëntor, 12:49

Aksident i trefishtë në aksin Levan - Tepelenë, një i plagosur (VIDEO)
9 Nëntor, 09:57

Kush janë 13 kandidatët në garë për drejtimin e 5 bashkive, në Vlorë dhe Mat 'rebelime' në parti
9 Nëntor, 06:52

LIVE TV- Zgjedhjet në 5 bashki, procesi pa probleme! Pjesëmarrje e ulët, deri në 15:00 votuan 15.39% e zgjedhësve
9 Nëntor, 06:29

Gjendja financiare dhe sfidat e kryetarëve të rinj në 5 bashkitë që shkojnë në zgjedhje! Vlora shpenzimet më të larta, Cërriku i 'mbytur' në borxhe
Eliza Gjediku
8 Nëntor, 13:24

Kokainë, para e fishekë gjuetie, arrestohen 2 persona në doganën e Kakavijës. Tentuan të fusnin sende të paligjshme në Shqipëri
7 Nëntor, 15:45

Të dielën zgjedhjet e pjesshme, Rama në 'Flasim': PD në hall kujt t'ia lërë humbjen në derë! Kandidatët e PS: Fitore të thellë
7 Nëntor, 09:37

Të dielën votohet në 5 bashki, nesër heshtje zgjedhore! KQZ shpërndan materialet zgjedhore, Policia do ruajë 473 QV
7 Nëntor, 09:29

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje